

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 120 Prot.

Tiranë, më 30.01 2017

VENDIM Nr. 5, datë 24.01.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1 të datës 24.01.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit të terrenit në kuadër të projektit "**Rikonstruksion dhe shtesë anësore e godinës së aparatit të KESH sh.a**", **Kryqëzimi i rrugës "Petro Korçari" me rrugën "Viktor Eftimiu", Tiranë**, "-subjekti "KESH" sh.a, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit të terrenit në kuadër të projektit "**Rikonstruksion dhe shtesë anësore e godinës së aparatit të KESH sh.a**", **Kryqëzimi i rrugës "Petro Korçari" me rrugën "Viktor Eftimiu", Tiranë**, "-subjekti "KESH" sh.a, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO PURXHI
MINISTRE



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO